

AKT THEMELIMI  
I  
SHOQËRISË

**“Shija” SH.P.K**

**Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me Dy Ortak**

Sot, me datë 20.05.2024 (dymijë e njëzet e katër), në Tiranë, pranë selisë së shoqërisë “Shija” sh.p.k, me pjesëmarrjen e ortakëve z.Ledian Zerba dhe z.Endri Cami, (*më poshtë njohur si “Ortakët”*) nënshkruhet ky Akt Themelimi, si vijon:

- **z.Ledian ZERBA**, shtetas shqiptar, lindur në Peshkopi , me datë 29-12-1995 (njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë), mbajtës i pasaportës (ID) me Nr.BE8314911 dhe Nr.Personal J51229053T dhe banues në Durrës në Rr. Dibrës, njohur këtu e mëposhtë si ortaku me pjesmarrje në përqindje 50% (pesëdhjetë përqind), të kapitalit të shoqërisë “Shija” sh.p.k.
- **z.Endri CAMI**, shtetas shqiptar, lindur në Peshkopi , me datë 09-01-1990 (njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë), mbajtës i letërnjoftim (ID) me Nr.036737702 dhe Nr.Personal J00109068C dhe banues në Durrës në Rr. Dibrës, njohur këtu e mëposhtë si ortaku me pjesmarrje në përqindje 50% (pesëdhjetë përqind), të kapitalit të shoqërisë “Shija” sh.p.k.

**I. Themelimi**

Ortakët deklarojnë në unanimitet të plotë, themelimin e shoqërisë “Shija” sh.p.k, si një shoqëri tregtare shqiptare me përgjegjësi të kufizuar (**“Shoqëria”**).

1. Selia administrative e Shoqërisë është në adresën: **Rr. Kongresi Përmet, Godina 85/1, Hyrja 2, Tiranë, Shqipëri.**

Shoqëria është themeluar me afat të papërcaktuar.

**II. Objekti**

Në përputhje me statutin dhe liçensat e përfituara nga institucionet përgjegjëse, shoqëria do të kryej veprimtarite, si më poshtë:

**Krijimi dhe menaxhimi i bareve, restoranteve, kafeneve dhe markave të tyre. Marrja me qira e ambienteve nga palë të treta dhe menaxhimi i tyre, për të siguruar shfrytëzim optimal dhe mirëmbajtje të vazhdueshme. Përgatitja e ushqimeve ose pijeve dhe shërbimi i tyre në ambientet fizike të restoranteve. Përgatitja e ushqimeve ose pijeve dhe shpërndarja e tyre jashtë ambienteve të restoranteve.**

**Shitblerja e markave dhe ambienteve të restoranteve nën portofolin e shoqërisë.**

**III. Statuti**

Ortakët z.Ledian ZERBA dhe z.Endri Cami, deklarojnë pajisjen e Shoqërisë me Statutin e Shoqërisë.

#### IV. Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerisë është 1,000,000 (një milionë) lekë, i përbërë nga 2 Kuota të Përgjithëshme. Kuota e shoqerisë zotërohen nga:

- z.Ledian Zerba me numër të pjesëve 1 kuotë dhe pjesëmarrje në përqindje 50% (pesëdhjetë përqind)
- z.Endri Cami me numër të pjesëve 1 kuotë dhe pjesëmarrje në përqindje 50% (pesëdhjetë përqind).

I gjithë kapitali i shoqerisë zotërohet nga:

- z.Ledian ZERBA, me vlerë kapitali në para 500,000 (pesëqindë mijë) lekë, me numër të pjesëve 1 kuotë dhe pjesëmarrje në përqindje 50% (pesëdhjetë përqind)
- z.Endri CAMI me vlerë kapitali në para 500,000 (pesëqindë mijë) lekë, me numër të pjesëve 1 kuotë dhe pjesëmarrje në përqindje 50% (pesëdhjetë përqind).

*Çdo kuotë i jep të drejten e një votë zoteruesit të tij.*

*Kapitali i Shoqerisë është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga Ortakët.*

#### V. Administratori

Shoqëria do të drejtohet fillimisht nga 2 (dy) Administrator. Administratori do të jetë përgjegjës për administrimin e përditshëm të Shoqerisë "Shija" sh.p.k, sipas kufizimeve të vendosura nga Statuti dhe legjislacionet e Republikës së Shqipërisë.

Administratorët e Shoqerisë "Shija" sh.p.k, emërohen:

- **z.Endri Cami**, shtetas shqiptar, lindur në Peshkopi, me datë 09-01-1990 (njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë), mbajtës i letërnjoftim (ID) me Nr.036737702 dhe Nr.Personal J00109068C dhe banues Durrës në Rr. Dibrës;
  - Administratori emërohet nga Ortakët e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqerisë, të cilët kanë të drejtën dhe kompetencat e plota ta shkarkojë me vendim të zakonshëm Administratorin, për çdo arsye.
  - Administratori emërohet për një afat 2 (dy) vjeçar dhe mund të ri-emërohet me vendim asambleje të përgjithshme të ortakut/ ortakeve të shoqerisë.
  - Kompetencat dhe detyrat e Administratorit, mund të ndryshohen me vendim asambleje të përgjithshëm të ortakut/ëve të shoqerisë.
- **z.Ledian ZERBA**, shtetas shqiptar, lindur në Peshkopi, me datë 29-12-1995 (njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë), mbajtës i pasaportës (ID) me Nr.BE8314911 dhe Nr.Personal J51229053T dhe banues Durrës në Rr. Dibrës;
  - Administratori emërohet nga Ortaku në cilesinë e anëtarit të vetëm të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqerisë, i cilët ka të drejtë dhe kompetencë të plotë ta shkarkojë me vendim të zakonshëm Administratorin, për çdo arsye.
  - Administratori emërohet për një 2 (dy) vjeçar dhe mund të ri-emërohet me vendim asambleje të përgjithshme të ortakut/ ortakeve të shoqerisë.

- Kompetencat dhe detyrat e Administratorit, mund te ndryshohen me vendim asambleje të përgjithshëm të ortakut/ëve të shoqërisë.

Shoqëria “**Shija**” **sh.p.k**, do të përfaqesohet ndaj të tretëve nëpërmjet nënshkrimit të vetëm të Administratorit të tij, të vendosur nën vulën e Shoqërisë, nëse nuk parashikohet ndryshe në Statutin e Shoqërisë dhe/ose në një vendim të ardhshëm të ortakut/ëve të shoqërisë.

#### **ORTAKËT**

**z.Ledian Zerba**



**z.Endri Cami**

